

RREGULLORE E PËRGJITHSHME E KAMPIONATIT "DOWNHILL"

1. Të përgjithshme

- 1.1 Federata Shqiptare e Çiklizmit organizon Kampionation Kombëtar "Downhill" DHI 2017.
- 1.2 Kampionati në edicionin 2017 do të përbëhet nga **pesë** gara.
- 1.3 Çdo garë ka sistem pikësh.
- 1.4 Çiklisti **Kampion Kombëtar "DOWNHILL 2017"** do të shpallet nga shuma e pikëve të marra në garat që ka marrë pjesë.

2. Klasat

- 2.1 Klasat e pjesëmarrësve do të jenë katër.

Meshkuj

Under 20

17-20 vjeç (të lindur nga 1 janari 1997 deri në 31 dhjetor 2000)

Elite

21-40 (të lindur nga 31 dhjetor 1996 deri në 1 janar 1977)

Master

40+ (të lindur para 1 janar 1977)

Femra

17+ (të lindur para 1 janari 2001)

3. Çiklistët

- 3.1 Të gjitha garat e Kampionatit janë të rezervuara vetëm për mbajtësit e një Licence Kombëtare Shqiptare gare vjetore ose ditore të vlefshme për vitin 2017 në disiplinën "DOWNHILL" DHI.
- 3.2 Mosha minimale e lejuar e çiklistëve pjesëmarrës është: të lindur përpara **1 janar 2001**.
- 3.3 Çdo pilot e ka të detyruar veshjen mbrojtëse minimale: Helmetë me nofull (full face), mbrojtëse për sytë, doreza, gjunjëza.

4. Biçikleta

- 4.1 Gara "DOWNHILL" DHI është një garë me biçikleta mountain bike.
- 4.2 Zgjedhja e biçikletës me të cilën mund të merret pjesë është në vullnetin e garuesit.
- 4.3 Nuk do të ketë nëndarje sipas tipologjisë së saj.
- 4.4 Fuqia shtytëse e biçikletës duhet të jetë vetëm nëpërmjet fuqisë fizike të sportistit.
- 4.5 Nuk lejohet ndërrimi i biçikletës gjatë garës.

5. Numrat e garës

- 5.1 Numri i garës është unik dhe i njëjtë për gjithë kampionatin.
- 5.2 Çdo garues do pajiset me dy numra ngjites që duhen vendosur në biçikletë.
- 5.1 Njëri numër vendoset në pjesën ballore të bicikletës ndërsa numri tjetër në tubin e sipërm të bicikletës pranë qafës së timonit.

6. Regjistrimet

6.1 Regjistrimi për çdo garë është i veçantë.

6.2 Afati i fundit për regjistrim është **72 orë** përpara fillimit të garës.

6.3 Numri maksimal i pilotëve në garë është **50** pilotë.

6.4 Në oraret e kontrollit administrativ, të gjithë pilotët duhet të paraqiten dhe të sjellin dokumentet e kërkuara specifikisht për çdo garë.

6.5 Mosparaqitja në këto orare përbën skualifikim nga gara.

7. Gjyqtaria

7.1 Gjyqtaria e garës përbëhet nga:

1- Drejtuesi i eventit

2- Drejtuesi i garës.

3- Juria sportive e kohëmatjes, numërimit dhe vendimarrjes.

4- Komisarët e pistës

5- Kujdestarët e pistës

6- Mjeku i garës

8. Pikët

8.1 Që të marrësh minimalisht një pikë duhet të kalosh vijën e startit.

8.2 Duhet të jenë minimalisht tre çiklistë të të njëjtit klasë në garë që të marrësh pikë.

8.3 Shkallëzimi i pikëve për çdo garë do të jetë:

Vendi	Pikët
1	30
2	25
3	22
4	18
5	16
6	15
7	14
8	13
9	12
10	11
11	10
12	9
13	8
14	7
15	6

Vendi	Pikët
16	5
17	4
18	3
19	2
20	1
21	1
22	1
23	1
24	1
25	1
26	1
27	1
28	1
29	1
30	1

8.4 Do të ketë fituesë për çdo klas.

9. Protestat

9.1 Çdo çiklist që ka një protestë, duhet ta depozitojë atë me shkrim menjëherë pranë jurisë.

9.2 Brenda 30 minutash nga depozitimi i kërkesës Juria do të japë përgjigjen.

9.3 Limiti kohor i ankesave është jo më vonë se 30 minuta pas publikimit të rezultatit final.

10. Asistenca mekanike

10.1 Do të ketë një vend të caktuar asistence mekanike vetëm për garuesit gjatë garës.

11.2 Lejohet të ndërrohen të gjitha pjesët e biçikletës përveç trupit.

11. Ceremonia e çmimeve

11.1 "60" minuta pas shpalljes së rezultatit, zhvillohet ceremonia e ndarjes së çmimeve. Vendi i parë, i dytë dhe i tretë - marrin kupë.

11.2 Në podium pilotët fitues duhet të jenë me veshjet e garës.